



Për: Mediat e shkruara dhe elektronike
Nga: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim
Subjekti: Z.Krasimir Karakacanov viziton AKR-në

Prishtinë, 27 shkurt 2008

Njoftim për media

Kryetari i partisë opozitare në Bullgari, VMRO z. Krasimir Karakacanov, e ka vizituar AKR-në me ç`rast u prit nga nënkryetari i kësaj partie z.Ibrahim Gashi, zv/shefja e Grupit Parlamentar të AKR-së, Rita Hajzeraj dhe Shefi i Protokollit, z. Shpend Kallaba.

Temë diskutimi në këtë takim pune ishte bashkëpunimi partiak si dhe politiko-ekonomik në mes të dy palëve. Nënkryetari Gashi, falënderoi kryetarin e VMRO-së, për iniciimin e debatit në parlamentin e Bullgarisë rreth pranimit të Republikës së Kosovës.

“Republika e Kosovës tashmë është pranuar nga shumë shtete. Vizita jonë ka të bëjë me procesin e pas pavarësimit, në mënyrë që të informojë parlamentin Bullgar me detajisht rreth Kosovës. Unë besoj se për një kohë shumë të shkurtë, vendet tona do të vendosin marrëdhënie të mira ndërshtetërore”, ka thënë Karakacanov.

Ndërkaq më tej është diskutuar rreth alternativave ekonomike që Republika e Kosovës mund t`i ketë me shtetin Bullgar, ku z.Gashi theksoi se bashkëpunimi në sferën ekonomike do të ishte një opsion i mirë, sidomos tash kur Serbia po bën ndalesa në këtë aspekt.

Kryetarja e Forumit të Gruas së AKR-së dhe njëkohësisht zv/shefja e Grupit Parlamentar të kësaj partie, zonja Rita Hajzeraj, pasi falënderoj z. Karakacanov për vizitën dhe gatishmërinë për ti ndihmuar Kosovës gjatë procesit të njohjes së Pavarësisë së vendit tonë, theksoi se Pavarësia e Kosovës është zgjidhja e vetme që ofron stabilitet afatgjatë, jo vetëm në Ballkan, por edhe në rajon. “Kosova po kalon ditët e para si shtet i Pavarur. Veçanërisht tani, ne kemi nevojë për mbështetjen e vendeve siç është Bullgaria. Shpallja e Kosovës Republikë e Pavarur, është padyshim zgjidhja e vetme e cila do të çoj Ballkanin drejt një gjendje stabil, duke qenë gjithmonë i gatshëm për tu integruar në EU” shtoi, zonja Hajzeraj.

Kryetari i partisë VMRO, njëkohësisht shef i grupit parlamentar të kësaj partie në Bullgari, e përfundoi vizitën e tij duke thënë se Bullgaria është njëra nga ato vende e cila për një kohë shumë të shkurtër do ta njohë Kosovën si shtet të Pavarur dhe Demokratik.